

LIGJI NR. 03/L-087

PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Me qëllim të themelimit të kornizës ligjore për rregullimin e ushtrimit të të drejtave pronësore në ndërmarrjet publike;

Me qëllim të qeverisjes korporative të ndërmarrjeve në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike; dhe

Për krijimin e strukturave efikase të raportimit dhe përgjegjësisë për të lejuar mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve të ndërmarrjeve publike;

Miraton këtë

LIGJ PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

KREU I

Dispozitat e Përgjithshme

**Neni 1
Fushëveprimi**

1.1 Ky ligj përcakton kornizën ligjore lidhur me pronësinë e Ndërmarrjeve Publike dhe qeverisjen e tyre korporative në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike.

1.2 Përveç kur shprehimisht është përcaktuar ndryshe në këtë ligj, dispozitat e ligjeve tjera të Kosovës (duke përfshirë, por pa u kufizuar, vetëm në Ligjin për Shoqëritë Tregtare) të cilat i rregullojnë shoqëritë aksionare si dhe drejtorët, menaxhmentin, aksionarët si dhe të drejtat dhe detyrimet e secilit nga të sipër cekurit, do të aplikohen në tërësi ndaj NP-ve, drejtorëve, menaxhmentit dhe aksionarëve të tyre.

**Neni 2
Përkufizimet dhe Referencat**

2.1 Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij ligji, termet dhe shprehjet në vijim - kurdo që përdoren në këtë ligj - kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto terme ose shprehje përdoren, qartësisht ka kuptim tjetër:

“**Filial**” në lidhje me një NP, do të thotë dhe përfshin (i) çdo NP tjetër, (ii) çdo ndërmarrje e cila kontrollohet ose është në pronësi prej 50% ose më shumë të NP-në në fjalë ose cilësdo NP tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë; dhe (iii) çdo subjekt ose ndërmarrje e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kontrollon një NP ose është pronare e 50% ose më shumë të aksioneve ose interesave pronësore në një NP.

“**Komisioni i Auditimit**” ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 24 të këtij ligji.

“**Bordi i Drejtorëve**” ka kuptimin e Bordit të Drejtorëve të NP-ve sikurse të përcaktuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

“NP Qendrore” nënkupton dhe përfshin të gjitha NP të përshkruara në Nenin 3.1 të këtij ligji.

“Kontroll” në lidhje me një ndërmarrje do të thotë posedimi i shumicës së aksioneve votuese (ose instrumentit përkatës) në atë ndërmarrje, ose mundësia për të ushtruar – qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes personave tjerë ose me bashkëpunimin e personave të tjerë; qoftë vetë ose bashkërisht me persona tjerë; dhe përmes votimit ose të drejtave kontraktuese, ose në ndonjë mënyrë tjetër – ndikim mbizotërues mbi vendimet më të rëndësishme të cilat janë në kompetencë të mbledhjes së aksionarëve (ose organit tjetër më të lartë vendimmarrës) të ndërmarrjes.

“Drejtor” ka kuptimin e çdo anëtari të Bordit të Drejtorëve të NP-ve.

“Interes Financiar” do të thotë çdo marrëdhënie, duke përfshirë, por pa u kufizuar në interesat pronësorë të cilat mbahen nga personi përkatës ose cilitdo person i cili është i afërm i shkallës së katërt të këtij personi (secila shkallë është numri i marrëdhënieve familjare – si martesë apo prindër – që e lidh një person me tjetrin, e llogaritur duke u ngritur nga personi i parë e gjer tek paraardhësi i parë i përbashkët dhe duke zbritur te personi i dytë; për shembull, dy vëllezër janë të afërm të shkallës së dytë, dhe dy kushërinj të parë janë të afërm të shkallës së katërt).

“Qeveria” nënkupton Qeverinë e Republikës së Kosovës.

“Komisioni Qeveritar për Privatizim” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 9.2 të këtij ligji.

“NP Lokale” nënkupton dhe përfshin të gjitha NP të përshkruara në nenin 3.2 të këtij ligji.

“Ministri” nënkupton Ministrin e Ekonomisë dhe Financave.

“Ministria” nënkupton Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

“Komuna” ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

“Komisioni Komunal i Aksionarëve” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 5.2 të këtij ligji.

“Sekretari i Përhershëm” nënkupton Sekretarin e Përhershëm në Zyrën e Kryeministrit.

“Ndërmarrje Publike” ose “NP” është term i përgjithshëm që nënkupton dhe përfshin të gjitha ndërmarrjet e përcaktuara në listat të cilat i janë bashkangjitur këtij ligji, duke përfshirë ndryshimet në këto lista të cilat bëhen nga Qeveria në përputhje me nenin 3.3 të këtij ligji.

“Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 37 të këtij ligji..

“Komisioni Rekomandues” do të thotë një komision i themeluar nga Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit në përputhje me nenin 15.2 të këtij ligji.

“Transaksionet me Palët e Ndërlidhura” do të thotë çdo transaksion, të çfarëdo natyre, në të cilin një NP përvetëson ose bart, në çfarëdo mënyre, mallra ose shërbime nga, ose për, cilindo person fizik ose juridik i cili (secili është “Palë e Ndërlidhur”):

- a) është filial i NP-së;
- b) është aksionar i NP-së ose cilëso nga filialet e saj i cili posedon më shumë se pesëmbëdhjetë përqind (15%) të të drejtave të votimit;
- c) gjatë tri (3) viteve të fundit ka qenë aksionari Kontrollues i NP-së;
- d) ka qenë drejtor, zyrtar ose menaxher i lartë i NP-së ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të fundit;
- e) është një bashkëpunëtor afarist i NP-së ose cilëso nga filialet e saj, ose është një filial, drejtor, zyrtar ose menaxher i lartë i kësaj sipërmarrje;
- f) është një sipërmarrje në të cilën NP ose cilado nga filialet e saj është pjesëmarrës, ose është filial, drejtor, zyrtar ose menaxher i lartë në këtë sipërmarrje;

g) është i afërm i shkallës së tretë ose më i afërt me cilindo nga personat fizik i cili kualifikohet në kategoritë më sipër; ose

h) është shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili kontrollohet ose ndikohet në masë të konsiderueshme nga cilido person fizik ose juridik i cili kualifikohet në kategoritë më sipër.

“Autoritet Publik” do të thotë secilën nga vijueset: (i) çdo organ, autoritet ose agjenci publike e cila - në bazë të një ligji ose akti tjetër themelor juridik - ushtron kompetenca ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative-publike ose gjyqësore, dhe përfshin (ii) çdo departament, pjesë ose nën-njësi të këtij organi ose autoriteti publik.

“Komisioni i zgjedhur” ka kuptimin e komisionit të zgjedhur të Ministrave të paraparë me nenin 5.1 të këtij ligji..

“Aksionar” nënkupton (i) për NP Qendrore, Republikën e Kosovës, dhe (ii) për NP Lokale, cilëndo komunë që posedon aksione në të.

2.2 Përveç nëse konteksti qartësisht kërkon një interpretim tjetër, të gjitha referencat në këtë ligj ndaj ligjeve, rregulloreve ose akteve të tjera nënligjore ose cilësdo dispozitë të caktuar të tyre duhet të interpretohen për të përfshirë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e tyre. Nëse ligji, rregullorja ose akti nënligjor është shfuqizuar dhe zëvendësuar me akte të reja që rregullojnë fushën e njëjtë, referencat në këtë ligj duhet të interpretohen për t'i përfshirë këto akte të reja dhe, sipas rastit, dispozitat gjegjëse në to.

2.3 Fjalët e cilësdo gjini të përdorura në këtë ligj nënkuptojnë edhe gjinitë e tjera dhe fjalët në numrin njëjës nënkuptojnë edhe numrin shumës dhe anasjelltas.

Neni 3 Pronësia

3.1 Të gjitha ndërmarrjet e radhitura në Listën 1 e cila i është bashkangjitur këtij ligji janë NP Qendrore. Të gjitha NP Qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës.

3.2 Të gjitha ndërmarrjet e radhitura në Listën 2 e cila i është bashkangjitur këtij ligji është NP Lokale. Të gjitha NP-të Lokale janë në pronësi të komunës ose komunave të përcaktuara në Listën 2, dhe përqindja e pronësisë së secilës komunë do të jetë siç është përcaktuar në Listën 2.

3.3 Varësisht nga kufizimi i përcaktuar në Nenin 3.4, Qeveria ka autorizimin dhe detyrimin për ndryshimin e këtyre listave sipas nevojës për të shtuar dhe klasifikuar cilëndo ndërmarrje e cila në mënyrë të vlefshme është konstatuar se është 50% ose më shumë në pronësi publike, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të Republikës së Kosovës në tërësi dhe/ose një ose më shumë autoritete publike të Republikës së Kosovës nëse kjo ndërmarrje tashmë nuk është përcaktuar në këto lista. Nëse një ndërmarrje e identifikuar në këtë mënyrë ofron shërbime ose për më pak se tri (3) komuna ose në fushën e mbledhjes së mbeturinave ajo ndërmarrje është NP Lokale, përndryshe do të jetë NP Qendrore. NP Lokale e identifikuar në këtë mënyrë do të jetë në pronësi të komunës ose komunave në të cilat ajo ndërmarrje ofron shërbimet e saj në kohën kur është identifikuar si NP Lokale. Nëse kjo NP Lokale ofron shërbime për më shumë se një komunë, përqindja e pronësisë së secilës komunë do të jetë e barabartë me përqindjen e klientëve të regjistruar të kësaj NP Lokale në atë komunë. Kjo përqindje do të përcaktohet nga Qeveria brenda tridhjetë (30) ditëve pas identifikimit të saj në përputhje me të dhënat më të fundit zyrtare në dispozicion të NP-së Lokale mbi vendndodhjen e klientëve të saj të regjistruar.

3.4 Një ndërmarrje nuk do të shtohet në këto lista nëse Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit e vendos këtë ndërmarrje dhe/ose cilindo interes pronësor në të nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ose nëse kjo ndërmarrje ishte nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit si ndërmarrje në pronësi shoqërore.

Neni 4

Organizimi; Aksionet

4.1 Të gjitha NP do të organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare.

4.2 Nëse një NP nuk është e organizuar si Shoqëri Aksionare në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pronari(ët) janë të detyruar ta kryejnë këtë organizim brenda njëqind e pesëdhjetë ditëve (150) ditëve pas kësaj date. Nëse pronari(ët) nuk e kryejnë organizimin brenda afatit të sipër cekur, Ministri është i autorizuar që ta kryejë organizimin në emër të tyre; në raste të këtilla Ministri do të jetë, në bazë të këtij ligji, përfaqësuesi ligjor i pronarëve dhe është i autorizuar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e organizimit. Nëse NP është NP Lokale, Ministri e ushtron këtë kompetencë vetëm pas konsultimit me Qeverinë dhe kryetarët e komunave përkatëse.

4.3 Të gjitha interesat pronësore në një NP do të përfaqësohen me aksione dhe të gjitha këto aksione duhet të jenë të regjistruara.

4.4 Njësia e Politikave dhe Monitorimit të NP në Ministri është kujdestari i të gjitha certifikatave fizike të cilat i përfaqësojnë aksionet në NP-të që janë në pronësi të Republikës së Kosovës ose një autoriteti publik.

Neni 5

Ushtrimi i të Drejtave të Aksionarit

5.1 Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore. Qeveria do të vendos mbi këto çështje me shumicë të thjeshtë votash. Me qëllim të përgatitjes së debatit në Qeveri, një komision i zgjedhur i Ministrave do të paraqesë propozime ose vërejtje mbi këto çështje. Aktet nënligjore të cilat do të miratohet në përputhje me Nenin 42 do t'i përcaktojnë rregullat dhe procedurat e komisionit të zgjedhur. Komisioni i zgjedhur gjithnjë duhet të përfshijë Ministrin e Ekonomisë dhe Financave; Ministria e Energjisë dhe Minierave; Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë; Ministrin e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit; dhe Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Vendimet e Qeverisë do të zbatohen nga Ministri, i cili, për këtë qëllim, ka të drejtë të veprojë në emër të Republikës së Kosovës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

5.2 Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.

Neni 6

Miratimi dhe Zbulimi i Politikës së Pronësisë

6.1 Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria do të përgatisë dhe nxjerrë një politike të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të Republikës së Kosovës në lidhje me pronësinë e NP-ve Qendrore, duke përfshirë – nëse Qeveria dëshiron – udhëzimet e saj strategjike mbi zhvillimin e veprimtarisë afariste të këtyre NP-ve, dhe rolin e saj në qeverisjen korporative të NP-ve Qendrore. Kjo politikë e pronësisë duhet të jenë të përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat tjera të aplikueshme ligjore në Kosovë. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbajë dispozita të hollësishme mbi mënyrën e zbatimit të saj.

6.2 Brenda njëqind e njëzet (120) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Komisioni Komunal i Aksionarëve i secilës komunë do të përgatisë dhe nxjerrë një politike të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të komunës në lidhje me pronësinë e NP-ve Lokale si dhe rolin e saj në qeverisjen korporative të NP-ve Lokale. Kjo politikë e pronësisë duhet të jenë të përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat tjera të aplikueshme ligjore në Kosovë. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbajë dispozita të hollësishme mbi mënyrën e zbatimit të saj. Nëse më shumë së një komunë posedon aksione

në një NP lokale, Komisionet përkatëse Komunale të Aksionarëve do të bashkëpunojnë për përgatitjen e një politike të përbashkët të pronësisë. Në rast se marrëveshje nuk mund të arrihet në lidhje me një element përmbajtjesor të politikës së përbashkët të pronësisë, çështja do të vendoset me shumicën e votave të Komisioneve përkatëse Komunale të Aksionarëve.

Neni 7

Mbikëqyrja nga Aksionarët dhe Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve

7.1 Aksionari(ët) e një NP do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së në fjalë.

7.2 Nëse performanca e NP-së devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit të miratuar nga Bordi i Drejtorëve për vitin përkatës financiar, Aksionari(ët) do të kërkojnë nga Bordi i Drejtorëve që të përgatisë dhe t'u dorëzojë atyre një raport i cili i shpjegon arsyet për performancën e dobët, dhe Aksionari(ët) do të marrin të gjitha masat e duhura korrigjuese.

7.3 Sido që të jetë, nëse një NP dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, personi(at) përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionarit është i detyruar që të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e Bordit të Drejtorëve ose shumicës së anëtarëve të tij. Një veprim i këtillë mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës nga Bordi ose anëtarët përkatës të bordit, përveç nëse Aksionari(ët) konstatojnë se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Personat përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të Aksionarit do t'ia raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të këtij Neni 7.3, dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi: (i) Kuvendit, për NP-të Qendrore, ose (ii) Kuvendit përkatës Komunal, për NP-të Lokale.

7.4 Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP do të shqyrtojë procesverbalet e cilës mbledhje të Bordeve të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-ve si dhe të gjitha dokumentet e dorëzuara. Kurdo që është e nevojshme, Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP do të kërkojë dorëzimin e të dhëna më specifike dhe po ashtu mund të kërkojë takim me Bordin e Drejtorëve. Kurdo që këto procesverbale, dokumente ose të dhëna shfaqin shqetësime lidhur me performancën e Bordit të Drejtorëve, menaxhmentit të NP-së ose vetë NP-së, Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve do ta njoftojë Aksionarin(ët) përkatës mbi këto shqetësime.

7.5 Komunikimi ndërmjet Aksionarit(ëve) ose Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve dhe Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit të një NP-je rregullisht do të kanalizohet përmes kryesuesit të, sipas rastit, Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit.

7.6 Detyrimi për mbikëqyrje i themeluar me këtë nen nuk do të ushtrohet në një mënyrë që ndërhyt, ose ka për qëllim të ndërhyt, me veprimtarinë ose pavarësinë e Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit të një NP.

7.7 Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve do t'i mbajë sekret dhe nuk do t'i bëjë publike të gjitha të dhënat të cilat Bordi i Drejtorëve i përcakton si sekrete.

Neni 8

Raportimi para Publikut mbi Përfundimin e Aksionarëve

8.1 Qeveria i përgjigjet Kuvendit për mënyrën në të cilën ajo, Ministri dhe Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP i ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë të cilat u janë dhënë me këtë ligj. Qeveria do t'i raportojë Kuvendit në bazë vjetore mbi performancën e këtyre autorizimeve dhe përgjegjësve si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.1 të këtij ligji. Qeveria do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit mbi mënyrën e menaxhimit të NP-ve Qendrore në interes të Republikës së Kosovës.

8.2 Çdo Komision Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të cilat u janë dhënë me këtë ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësive, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.2 të këtij

ligji.. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të NP-së përkatëse Lokale në interes të Komunës ose Komunave përkatëse.

Neni 9 Shitja e Aksioneve

9.1 Aksionet në një NP Qendrore mund të shiten lirisht nëse Qeveria miraton një vendim me shkrim me të cilin autorizohet një Komision Qeveritar për Privatizim për të vazhduar me tenderimin dhe shitjen e aksioneve, me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Kosovës. Pas miratimit të këtij vendimi nga Qeveria dhe Kuvendi, Komisioni Qeveritar për Privatizim është i autorizuar të kryejë një tender dhe t'i shesë aksionet në fjalë.

9.2 Secili Komision Qeveritar për Privatizim përbëhet nga pesë anëtarë: (i) Ministri i Ekonomisë dhe Financave, i cili e kryeson komisionin, (ii) Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, (iii) ministri i ministrisë e cila ka rolin udhëheqës të politik bërjes në sektorin në të cilin vepron NP Qendrore; dhe (iv) dy ministra të tjerë të emëruar nga Qeveria. Qeveria është e detyruar të sigurojë që njëri nga ministrat në secilin Komision Qeveritar për Privatizim të jetë nga një komunitet jo-shumicë.

9.3 Komisioni Qeveritar për Privatizim do të mbështetet nga një sekretari e cila do të themelohet për këtë qëllim nga Ministri në kuadër të Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave; sekretaria do të përfshijë ose të përkrahet nga këshilltarë të jashtëm profesional të cilët Komisioni Qeveritar i Privatizimit i konsideron të nevojshëm.

9.4 Tenderimi dhe shitja e aksioneve në një NP Qendrore do të realizohet nga Komisioni Qeveritar për Privatizim me procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese. Kushtet e kësaj procedurë do të përgatiten nga komisioni përkatës për privatizim, i cili duhet – së paku – të sigurojë që tenderimi dhe shitja e këtyre aksioneve të jetë në përputhje me kushtet procedurale të parapara në Ligjin për Procedurën e Dhënies së Koncesioneve.

Neni 10 Financimi i Aksionarëve

10.1 Aksionari nuk ka asnjë detyrim për financimin e NP-së; dhe Aksionari nuk do ta financojë NP-në përveç nëse shprehimisht autorizohet në bazë të një Ligji Vjetor për Ndarjet Buxhetore ose një ligji tjetër të miratuar nga Kuvendi i Kosovës; në raste të këtilla, financimi duhet të bëhet në përputhje me dispozitat e aplikueshme të atij ligji dhe të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

10.2 Pa paragjykuar paragrafin më sipër, shprehimisht përcaktohet se fitimet ose burimet tjera financiare të një NP nuk do të transferohen, huazohen ose përndryshe të shfrytëzohen për subvencionimin ose sigurimin e çfarëdo lloji tjetër të përkrahjes financiare ose kapitale për një NP tjetër.

Neni 11 Themelimi i Ndërmarrjeve të reja Publike

11.1 Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, çdo ndërmarrje e re publike mund të themelohet vetëm nëse kjo autorizohet me një vendim të Qeverisë.

11.2 Përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe në ligjin e sipër cekur, ndërmarrja e re publike do të jetë NP Qendrore.

KREU II Kushtet për Veprimtarinë e Ndërmarrjeve Publike

Neni 12

Detyrimet e Përgjithshme të NP dhe Drejtorëve të saj

12.1 Ndërmarrja Publike e ushtron veprimtarinë me qëllim të rritjes afat-gjate të vlerës së ndërmarrjes dhe aksionarëve.

12.2 Konform të drejtave dhe detyrimeve të tyre të themeluara me ligje të tjera, drejtorët e Ndërmarrjes Publike duhet të veprojnë në përputhje me strategjitë afariste dhe financare të përshkruara në Planin e miratuar të Biznesit të NP-së.

12.3 Pavarësisht nga të drejtat dhe detyrimet e aksionarëve të themeluara në ligje të tjera, drejtorët e Ndërmarrjes Publike duhet të sigurojnë që të gjithë aksionarët e saj të trajtohen në mënyrë të barabartë.

12.4 Një drejtor është i detyruar që t'i kushtojë kohë të mjaftueshme ushtrimit të rregullt të detyrave të tij si drejtor, duke përfshirë kohën e pjesëmarrjes dhe përgatitjes për mbledhjet e Bordit.

Neni 13

Kushtet e Barabarta Ligjore

13.1 Përveç nëse shprehimisht është përcaktuar ndryshe në këtë ligj, të gjitha NP si dhe zyrtarët dhe drejtorët e tyre, pa asnjë përjashtim, i nënshtrohen ligjeve, rregulloreve dhe akteve nënligjore të cilat i rregullojnë shoqëritë tregtare në pronësi private. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, shprehimisht përcaktohet se Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme ka kompetencën ekskluzive për të gjitha procedurat e paaftësisë paguese (insolvensës), likuidimit ose riorganizimit të një NP.

13.2 Pa e paragjykuar paragrafin më sipër, shprehimisht përcaktohet se NP i nënshtrohen plotësisht të gjitha ligjeve të cilat themelojnë detyrime ose kushte të veçanta, duke përfshirë kushte rregullatore, për pjesëmarrësit në industrinë ose sektorin në të cilin NP ushtron veprimtarinë e saj afariste.

13.3 Përveç nëse shprehimisht është përcaktuar ndryshe në këtë ligj, të gjitha NP po ashtu i nënshtrohen dhe duhet të veprojnë në përputhje me të gjitha elementet e aplikueshme të ligjit të Kosovës të cilat themelojnë dispozita për rregullimin e ndërmarrjeve publike.

Neni 14

Raportimi Financiar

14.1 NP duhet të veprojë në përputhje të plotë me të gjitha kushtet për raportim financiar dhe parimet e kontabilitetit për shoqëritë aksionare të përcaktuara në ligjin për shoqëritë tregtare.

14.2 NP duhet të veprojë në përputhje të plotë me udhëzimet administrative të nxjerra nga Thesari për përgatitjen e raporteve financiare të cilat kërkohen nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

14.3 Në përputhje parimet e kontabilitetit të përmendura në Nenin 14.1, llogaritë financiare të secilës NP duhet ti identifikojnë në mënyrë të veçantë të gjitha shpenzimet e bëra dhe të ardhurat e mbledhura gjatë ushtrimit të detyrimeve për shërbimin e publikut, nëse ka të tilla. Pas miratimit të deklaratave të saj vjetore financiare, NP duhet të përgatisë dhe publikojë në një faqe në internet me qasje publike një deklaratë gjithëpërfshirëse e cila e paraqet realizimin e qëllimeve të NP në relacion me caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit.

KREU III

Drejtorët e NP

Neni 15 Zgjedhja e Drejtorëve të NP Qendrore

15.1 Bordi i Drejtorëve të një NP Qendrore do të përbëhet nga pesë (5) ose shtatë (7) drejtorë. Numri i drejtorëve të cilësdo NP të caktuar Qendrore do të mbetet i njëjtë me numrin e drejtorëve të NP-së në fjalë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji; me kusht që, nëse, në këtë datë, NP qendrore ka tetë (8) ose më shumë drejtorë, atëherë numri i drejtorëve të saj do të jetë shtatë (7). Të gjithë drejtorët, përveç njërit, do të zgjidhen nga Qeveria; dhe secili drejtor i zgjedhur në këtë mënyrë shërben me mandat prej tri (3) viteve. Drejtori tjetër do të jetë KE i NP-së dhe zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të këtij ligji. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve të bordit të drejtorëve të një NP Qendrore, Qeveria mund të zgjedhë vetëm personat të cilët i janë rekomanduar Qeverisë nga Komisioni përkatës Rekomandues i themeluar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve, Qeveria duhet të sigurojë që së paku dy (2) drejtorë të jenë ekspert, ose së paku të kenë njohuri adekuate, të kontabilitetit, siç kërkohet nga neni 17.4 të këtij ligji..

15.2 Për çdo NP, Sekretari i Përhershëm do të emërojë një Komision Rekomandues prej shtatë (7) personave që të identifikojë dhe rekomandojë Qeverisë kandidatët për pozitën e drejtorit në bordin e NP-së përkatëse. Gjatë emërimit të anëtarëve të Komisionit Rekomandues, Sekretari i Përhershëm (i) duhet të emërojë vetëm shërbyes të lartë civil ose ekspertë të jashtëm me kualifikime të larta dhe me përvojë nga industria përkatëse, financa ose qeverisja korporative; (ii) nuk duhet të emërojë më shumë se një person nga një autoritet publik ose institucion i caktuar, (iii) nëse një ministri ka rol udhëheqës të politik bërjes në sektorin në të cilin NP ushtron veprimtarinë e saj, duhet të emërojë një person nga ajo ministri. Nëse i posedon kualifikimet e nevojshme, një person mund të shërbejë në më shumë se një Komision Rekomandues.

15.3 Sekretari i Përhershëm do të përgatisë dhe shpallë rregullat të cilat duhet të zbatohen nga secili Komision Rekomandues, duke përfshirë rregullat për identifikimin dhe trajtimin e konfliktit të interesave si dhe rregullat për metodologjinë e vlerësimit të cilat duhet të përdoren gjatë vlerësimit të kandidatëve.

15.4 Komisioni Rekomandues i rekomandon Qeverisë vetëm personat të cilët (i) i plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafët 1-3 të nenit 17 dhe (ii) kanë dhënë deklaratën në betim të kërkuar sipas nenit 17.5 të këtij ligji.. Çdo Komision Rekomandues gjithashtu duhet të sigurojë që një numër i përshtatshëm i kandidatëve të jenë ekspert, ose së paku adekuate, në kontabilitet, për t'i lejuar Qeverisë dhe Ministrin që të sigurojnë përputhjen me nenin 17.4 të këtij ligji..

15.5 Çdo Komision Rekomandues duhet të sigurojë që secili person i cili kërkon të merret parasysh për një pozitë të drejtorit të marrë një rekomandim pozitiv ose negativ i cili (i) bazohet ekskluzivisht në kualifikimet, meritën dhe përshtatshmërinë e tij profesionale, (ii) epet vetëm pas kryerjes së një kërkimi për kandidatë të kualifikuar përmes një konkurrimi të hapur, transparent dhe të shpallur publikisht, dhe (iii) epet vetëm pasi që secili anëtar i Komisionit Rekomandues të ketë dorëzuar një deklaratë nën betim në të cilën: (A) identifikohen, për aq sa ka njohuri anëtari, çfarëdo marrëdhënie familjare, personale ose afariste që anëtari në fjalë i ka me kandidatin përkatës, (B) identifikohet, për aq sa ka njohuri anëtari, çfarëdo konflikti i interesave i cili mund të ketë ndikuar, ose mund të duket se ka ndikuar, në vendimin e anëtarit dhe (C) konfirmohet se rekomandimi nuk është bazuar në çfarëdo mënyrë nga një marrëdhënie, konflikt i interesave ose ndikim i jashtë, pavarësisht nëse është zbuluar apo jo në deklaratën nën betim.

15.6 Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve në Komisionin Rekomandues nga kandidatët për drejtor do të jetë së paku tridhjetë (30) ditë kalendarike pas publikimit të shpalljes publike të kërkuar nga neni 15.5 i këtij ligji.. Komisioni Rekomandues do t'i intervistojë dhe vlerësojë të gjithë kandidatët. Komisioni Rekomandues nuk do t'i marrë parasysh aplikacionet e dorëzuara pas afatit të fundit të përcaktuar në shpallje.

15.7 Kurdo që është e mundur, Komisioni Rekomandues do t'i rekomandojë Qeverisë një numër të kandidatëve të kualifikuar që është së paku pesë (5) më shumë se numri i pozitave për drejtor të zgjedhur në Bordin e Drejtorëve. Komisioni Rekomandues do të sigurojë Qeverisë vlerësimin me shkrim të secilit kandidat të rekomanduar. Gjatë rekomandimit për Qeverinë, Komisioni Rekomandues duhet të marrë parasysh nevojën e NP-së që të ketë një Bord të Drejtorëve të përbërë nga anëtarë me talente dhe ekspertizë të kombinuar profesionale.

15.8 Nëse një anëtar i një Bordi të NP nuk është në gjendje që ta përfundojë mandatin e tij/saj, pasardhësi do të zgjidhet nga Qeveria (i) nga lista e kandidatëve e cila e fundit i është propozuar nga

Komisioni Rekomandues ose, (ii) nëse asnjë kandidat i këtillë nuk është në dispozicion, në përputhje me procedurën e përcaktuar më sipër.

15.9 Një drejtor ekzistues i një NP Qendrore mund të rekomandohet nga Komisioni përkatës Rekomandues më shumë se një herë nëse ai nuk shkualifikohet për shkak të nenit 17.2(h) dhe nëse ai nuk do të bëhet i shkualifikuar për shkak të nenit 17.2(h) gjatë mandatit përkatës.

15.10 Asnjë person nuk do të përpiqet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të ndikojë në një Komision Rekomandues gjatë ushtrimit të detyrave të tij për identifikimin dhe rekomandimin e kandidatëve.

15.11 Qeveria ka autorizimin dhe përgjegjësinë që të caktojë njërin nga drejtorët e zgjedhur të NP-së Qendrore që të shërbejë si Kryesues i Bordit të Drejtorëve të NP-së përkatëse. Ministri ka autorizimin dhe përgjegjësinë që të caktojë një drejtor për të shërbyer si ushtrues detyre i Kryesuesit deri në kohën e caktimit të Kryesuesit nga Qeveria.

15.12 Asnjë anëtar i Bordit të Drejtorëve të NP-së, përveç anëtarit i cili është KE i NP-së nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. KE nuk mund të shërbejë si kryesues ose ushtrues i detyrës së kryesuesit në Bordin e Drejtorëve.

15.13 Çdo person i cili konstatohet se me vetëdije ka dorëzuar një deklaratë të rrejshme ose mashtruese nën betim sipas paragrafit 5 të këtij neni, ose i cili konstatohet se ka ndikuar ose është përpjekur të ndikojë në një Komision Rekomandues në kundërshtim me paragrafin 10 të këtij neni, konsiderohet të ketë kryer vepër penale dhe i nënshtrohet një gjobe prej 10,000 Euro. Nëse, personi në fjalë është shërbyes civil, Qeveria menjëherë do ta largojë atë nga shërbimi civil; nëse personi në fjalë është zyrtar i zgjedhur politik, Qeveria do t'ia raportojë shkeljen dhe emrin e zyrtarit Kuvendit.

Neni 16 Zgjedhja e Drejtorëve të NP Lokale

16.1 Bordi i Drejtorëve të një NP Lokale do të përbëhet nga pesë (5) drejtorë.

16.2 Katër (4) drejtorë zgjidhen në një mbledhje të aksionarëve në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare; dhe secili ka mandat prej tri (3) viteve. Komisioni Komunal i Aksionarëve e përfaqëson komunën në këtë mbledhje dhe i ushtron të drejtat e votimit të komunës në përputhje me nenin 5.2 të këtij ligji. Drejtori tjetër është KE i NP-së i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të këtij ligji.

16.3 Nëse më shumë se një komunë posedon aksione në një NP Lokale: (i) secili Komision Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të zgjedhë një drejtor; dhe (ii) drejtorët e mbetur të cilët duhet të zgjidhen nga aksionarët do të zgjidhen nga Komisionet përkatëse Komunale të Aksionarëve në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare të cilat rregullojnë zgjedhjen e drejtorëve të një shoqërie aksionare.

16.4 Gjatë zgjedhjes së drejtorëve, Komisioni(et) Komunale të Aksionarëve duhet të sigurojnë që së paku dy (2) drejtorë të zgjedhur të jenë ekspert, ose së paku të kenë njohuri adekuate, të kontabilitetit, siç kërkohet nga neni 17.4 të këtij ligji.

16.5 Asnjë person nuk mund të propozohet ose të zgjidhet për një pozitë të drejtorit nëse nuk i përbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale të përcaktuara në paragrafët 1-3 të nenit 17 të këtij ligji. dhe nëse nuk e ka bërë betimin me shkrim të kërkuar sipas nenit 17.5 të këtij ligji. Secili Komision Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të identifikojë dhe propozojë kandidatë të kualifikuar për zgjedhe në Bordin e Drejtorëve të NP Lokale; me kusht që, të gjithë personat e propozuar në këtë mënyrë ti përmbushin kushtet e sipër cekura të kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale si dhe të kenë dhënë deklaratën në betim.

16.6 Bordi i drejtorëve të një NP Lokale, menjëherë pas zgjedhje, do të zgjedhë njërin nga anëtarët e tij për të shërbyer si kryesues. Përveç anëtarit i cili shërben si KE i NP-së Lokale, asnjë anëtar i Bordit të Drejtorëve të një NP Lokale nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. KE nuk mund të shërbejë si kryesues ose ushtrues detyre i kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.

Neni 17
Kushtet e Kualifikimit dhe Përshtatshmërisë Profesionale

17.1 Një person ka të drejtë të shërbejë si drejtor vetëm nëse i plotëson të gjitha kushtet më poshtë si dhe kushtet për pavarësi dhe përshtatshmëri profesionale të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 17 të këtij ligji:

a) nuk është dënuar ose vendosur nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës, se ka kryer vepër penale ose civile vepër penale apo civile që përfshin përgënjeshtrimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve, ka qenë i përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare;

b) nuk është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo-profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keq-përvetësuar apo ka keqpërdorur paratë apo burimet publike, (iv) se keqpërdorur apo keq-përvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo;

c) nuk ka bërë përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar; dhe

d) nuk është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara;

17.2 Të gjithë drejtorët përveç KE duhet të jenë të pavarur. Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

a) aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara;

b) aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;

c) aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;

d) është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;

e) pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj;

f) mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;

g) përfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;

h) ka shërbyes në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;

i) është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të këtij ligji) i cilitdo person që i takon cilëso nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b); ose

j) është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurren me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen; dhe

k) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;

l) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

17.3 Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t'i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

a) duhet të jetë person që ka integritet të njohur, duke marrë parasysh, ndër tjera, çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilitdo person tjetër;

b) duhet ose (i) të ketë së paku pesë (5) vite përvojë – së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit – në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesari, banka, konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

17.4 Çdo Bord i Drejtorëve i një NP duhet të ketë së paku dy (2) drejtorë të cilët janë ekspert, ose së paku të kenë njohuri adekuate, në kontabilitet.

17.5 Çdo person i cili mban ose aplikon për një pozitë të drejtorit duhet të japë një deklaratë nën betim në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni. Çdo përgënjeshtër material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në shkualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

17.6 Të gjithë drejtorët e NP do të kërkohen që, një herë në vit, të vijnë në një kurs të trajnimit në fushën e qeverisjes korporative. Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP është përgjegjëse për organizimin e këtij kursi dhe për të siguruar që secili Drejtor i NP-së t'i plotësojë kërkesat e paragrafit 6 të këtij neni. Nëse një Drejtor nuk i plotëson këto kërkesa, Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP e njofton Qeverinë mbi këtë dhe drejtori përkatës nuk do të ketë të drejtë për riemërim pas përfundimit të mandatit të tij/saj.

Neni 18 **Mbikëqyrja nga Bordi i Drejtorëve**

18.1 Bordi i Drejtorëve të NP-së do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së.

18.2 Nëse performanca e NP-së devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit për vitin përkatës financiar, Bordi i Drejtorëve do të kërkojë një raport nga KE i shpjegon arsyet për performancën e dobët, dhe do të marrë të gjitha masat e duhura korrigjuese.

18.3 Sido që të jetë, nëse NP dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, Bordi i Drejtorëve është i detyruar të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e KE-së. Ky veprim mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës, përveç nëse Bordi i Drejtorëve konstaton se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Bordi i Drejtorëve do t'ia raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të këtij Neni 18.3, dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi: (i) Qeverisë, për NP-të Qendrore, ose (ii) Kuvendit(eve) përkatës Komunal, për NP-të Lokale.

Neni 19 **Zbatimi i Detyrave të Besuara (Fiduciare) të Drejtorëve**

19.1 Kurdo që ka informata të besueshme se Bordi i Drejtorëve ose një drejtor individual i NP-së ka vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre fiduciare, Aksionari(ët) do të zhvillojnë një hetim të hollësishëm dhe pa vonesë.

19.2 Nëse Aksionari(ët) konstatojnë se shkelja në fakt ka ndodhur, Aksionari(ët) (i) menjëherë do ta shkarkojë dhe zëvendësojë drejtorin ose drejtorët përgjegjës dhe (ii) NP menjëherë duhet të kërkojë masa ligjore kundër drejtorëve të cilët kanë bërë shkeljen kurdo që provat në dispozicion me arsye supozohet se janë të mjaftueshme për ngritjen e suksesshme të një padie për kompensimin e dëmeve që i janë shkaktuar NP-së nga shkelja; megjithatë, NP nuk është e detyruar që të paraqesë padi kundër drejtorit(ëve) të cilët kanë bërë shkeljen nëse me arsye ka gjasa se shumica e kompensimit e cila mund të fitohet do të jetë më e ulët se shpenzimet të cilat me arsye pritet se do t'i ketë NP-ja gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore.

19.3 Nëse Aksionari(ët) kanë arsye për të besuar se ka mundësi që një drejtor të ketë bërë shkeljen e detyrave fiduciare, ata menjëherë do ta shkarkojnë dhe zëvendësojnë drejtorin ose drejtorët të cilët me arsye besohet se kanë bërë shkeljen e detyrave të tyre fiduciare, edhe në mungesë të provave të qarta, pavarësisht nga rreziku që mund të paraqesë për NP-në ngritja e një padie nga ana e drejtorit/ëve të shkarkuar.

Neni 20 **Kompensimi i Drejtorëve të NP**

20.1 Drejtorëve do t'u paguhet një honorar themelor, i cili përcaktohet në përputhje me Nenin 20.2, për kohën e shpenzuar në mbledhjet e Bordit. Drejtorëve po ashtu do t'u paguhet një kompensim për stimulimin e efektshmërisë në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit e cila përgatitet dhe zbulohet nga Komisioni i Auditimit i Bordit të Drejtorëve në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.

20.2 Honorari themelor për drejtorët e NP do të përcaktohet (i) me një vendim me shkrim të Qeverisë së Kosovës për NP Qendrore, dhe (ii) me një vendim të Komisionit(ëve) përkatës Komunal të Aksionarëve, për NP Lokale. Honorari themelor për drejtorët e një NP Lokale nuk do të jetë më i lartë se kompensimi i caktuar nga Qeveria për drejtorët e një NP Qendrore. Nëse një NP Lokale është në pronësi të më shumë se një komune, vendimi për shkallën e honorarit themelor të drejtorëve do të jetë subjekt i votimit nga Komisionet Komunale të Aksionarëve, me ç'rast secili komision do të ketë të drejtë të hedhë numrin e votave që është i barabartë me aksionet në pronësi të komunës përkatëse.

20.3 Shkalla e honorarit themelor do të caktohet në një nivel i cili pritet të tërheqë aplikacione nga persona kompetent (i) të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafët 1-4 të nenit 17 të këtij ligji, dhe (ii) të cilët në masë të arsyeshme pritet se do t'i ushtrorjnë në mënyrë profesionale dhe të përgjegjshme detyrat e drejtorit të përcaktuara në këtë ligj dhe në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

20.4 Komisioni i Auditimit do të përgatisë dhe të zbulojë në mënyrë publike një deklaratë për politikën e kompensimit për drejtorët dhe zyrtarët e NP-së.

20.5 Kjo deklaratë për politikën e kompensimit duhet, ndër tjera (i) të përcaktojë raportin ndërmjet kompensimit, posaçërisht kompensimit për stimulimin e efektshmërisë, dhe performancës si dhe duhet të përfshijë standarde të matshme të cilat vënë theksin mbi interesat afatgjate të NP-së dhe jo ato afatshkurte; (ii) të përfshijë pagesat (nëse ka), të cilat do të bëhen në rast të ndërprerjes së kontratës së një zyrtari; dhe kontratat e punësimit të të gjithë zyrtarëve duhet t'i pasqyrojë dhe përfshijnë dispozitat përkatëse të kësaj politike të kompensimit, (iii) ta kufizojë kompensimin për stimulimin e performancës vjetore (nëse ka) e cila u paguhet drejtorëve, në një shumë e cila nuk është më e lartë se shumica e përgjithshme vjetore e honorarit themelor të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, dhe (iv) nëse në kuadër të politikës së kompensimit po ashtu është paraparë kompensimi për stimulimin e performancës së KE-së në lidhje me ushtrimin e detyrave të tij si zyrtar, atëherë nuk duhet të lejojë që KE po ashtu të marrë pjesë në kompensimin për stimulimin e performancës e cila u paguhet drejtorëve.

20.6 NP është përgjegjëse për pagimin e të gjithë kompensimit për drejtorët e saj. Drejtorët e NP nuk do të marrin asnjë kompensim ose përfitim tjetër nga NP.

KREU IV

Zyrtarëve e NP-ve

Neni 21

Zgjedhja dhe Emërimi i Zyrtarëve të NP

21.1 Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarimin e arsyes. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Komisioni i Auditimit ka kompetencën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e Zyrtarin për Auditim të Brendshëm, i cili shërben për Komisionin e Auditimit, i cili mundet, në çdo kohë dhe me shumicë votash, ta ndërpresë kontratën e këtij zyrtari me ose pa deklarimin e arsyes. Ky Nen 21.1 mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, dhe do të pasqyrohet në Rregulloren e NP-së.

21.2 Rregulloret e miratuara nga Bordi i Drejtorëve sipas Neni 34, ndër tjera, do të përcaktojnë titullin, detyrat dhe përgjegjësitë e cilit zyrtar të NP-së.

21.3 Secila NP do të ketë këta katër zyrtarë në vijim: (i) Kryeshefin Ekzekutiv, (ii) Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, (iii) Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarit e Korporativ dhe (iv) një Zyrtar për Auditim të Brendshëm. Nëse është e nevojshme për shkak të madhësisë dhe/ose llojllojshmërisë së veprimtarive, NP mundet – nëse vendoset nga Bordi i Drejtorëve dhe përcaktohet në Rregullore – që po ashtu të ketë një ose dy poste të Zëvendës Kryetarit.

21.4 Për përzgjedhjen së personave për emërim si zyrtarë të NP-së, Bordi i Drejtorëve duhet të kryejë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese e cila ka për qëllim që të gjitha emërimet të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjithë personat e emëruar si zyrtarë të jenë person me integritet të njohur të cilët (i) i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas Nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) dhe (iii) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; me kusht që (i) Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit; (ii) Këshilltari i Përgjithshëm / Sekretari i Korporatës të posedojë diplomë universitare në ligj dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare; dhe (iii) Zyrtari për Auditim të Brendshëm të jetë person ekspert në kontabilitet,

Neni 22

Kompensimi i Zyrtarëve të NP

22.1 Kompensimi dhe përfitimet e zyrtarëve të NP do të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit të NP-së të përgatitur dhe të zbuluar nga Komisioni i Auditimit sipas nenit 20.4 të këtij ligji.

22.2 Shkalla e kompensimit dhe përfitimet e zyrtarëve të NP do të caktohet në një nivel i cili pritet të tërheqë aplikacione nga persona kompetent të cilët në masë të arsyeshme pritet se do ti ushtrojnë në mënyrë profesionale, të përgjegjshme dhe me orar të plotë detyrat e pozitës përkatëse. Nivele të ndryshme të kompensimit dhe përfitimeve mund të përcaktohen për secilën pozitë të zyrtarit brenda secilës NP të caktuar. Gjatë përcaktimit të nivelit të kompensimit dhe përfitimeve për një pozitë të zyrtarit të NP, do të merren parasysh detyruar e pozitës përkatësi si dhe madhësia, natyra dhe kompleksiteti i veprimtarisë së NP-së përkatëse.

22.3 NP është përgjegjësi për pagimin e kompensimit dhe sigurimin e përfitimeve tjera për zyrtarët e saj.

Neni 23

Zbatimi i Detyrave Fiduciare të Zyrtarëve

23.1 Kurdo që ka informata të besueshme se cilido nga zyrtarët (duke përjashtuar Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm, i cili i nënshtrohet ekskluzivisht autoritetit të Komisionit të Auditimit) ka vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre fiduciare, Bordi i Drejtorëve do të zhvillojnë një hetim të hollësishëm dhe pafundësi.

23.2 Nëse Bordi i Drejtorëve konstaton se një zyrtar ka bërë shkeljen e cilësdo nga detyrat e tij fiduciare, Bordi i Drejtorëve (i) menjëherë do ta shkarkojë dhe zëvendësojë këtë zyrtar, dhe (ii) NP është e detyruar që menjëherë do të kërkojë marrjen e masave ligjore kundër këtij zyrtari, kurdo që provat në dispozicion me arsye konsiderohet se janë të mjaftueshme për ngritjen e sukseshme të një padie për kompensimin e dëmeve që i janë shkaktuar NP-së nga shkelja; megjithatë, NP nuk është e detyruar që të paraqesë padi kundër zyrtarit në fjalë nëse me arsye ka gjasa se shuma e kompensimit e cila mund të fitohet do të jetë më e ulët se shpenzimet të cilat me arsye pritet se do t'i ketë NP-ja gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore.

KREU V

Komisioni i Auditimit

Neni 24 Komisioni i Auditimit

24.1 Çdo Komision i Auditimit do të përbëhet nga tre (3) drejtorë të zgjedhur. Komisioni i Auditimit caktohet nga Aksionari(ët). Së paku dy (2) anëtarë të caktuar në këtë mënyrë duhet të jenë drejtorë të cilët janë ekspert, ose së paku kanë njohuri adekuate në kontabilitet. Anëtari i tretë do të jetë një drejtor tjetër, përveç KE-së ose kryesuesit.

24.2 Komisioni i auditimit do të vërtetojë nëse veprimtaria dhe punët e NP-së janë duke u ushtruar në mënyrë të ligjshme, të përgjegjshme, dhe ekskluzivisht në interes të Aksionarit(ëve).

24.3 Komisioni i Auditimit do ta caktojë kryesuesit e vet.

Neni 25 Funksionet dhe Kompetencat e Komisionit të Auditimit

25.1 Kompetencat e Komisionit të Auditimit janë ekskluzive.

25.2 Komisioni i Auditimit, me përgjegjësi kolektive:

a) do t'i përmbahet Statutit dhe Rregulloreve të NP-së;

b) do t'i shqyrtojë planet afat-gjate strategjike, të investimeve dhe financiare të NP-së – së bashku me çfarëdo ndryshim plotësime të tyre – si dhe planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor para miratimit të tyre nga Bordi i Drejtorëve në tërësi, si dhe t'i sigurojë këtij të fundit të gjitha vërejtjet ose kundërshtimet të cilat i konsideron të nevojshme;

c) para miratimit nga Bordi i Drejtorëve (i) do të shqyrtojë pasqyrën vjetore të bilancit si dhe deklaratën e fitimeve dhe humbjeve të NP-së si dhe cilat do deklarata tjera financiare që kërkojnë me ligj, si dhe raportin vjetor mbi menaxhimin, politikën afariste dhe financiare dhe gjendjen industriale të NP-së; dhe (ii) do t'i dorëzojë Bordit të Drejtorëve një raport mbi përshtatshmërinë, saktësinë, vërtetësinë dhe përputhjen me ligjin të këtyre dokumenteve;

d) rregullisht do të shqyrtojë gjendjen financiare të NP-së dhe kushtet e saj të planifikuara financiare, si dhe do t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;

e) rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;

f) rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP-së, duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, dhe që projekt-deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt, dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;

g) rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP të të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të saj, dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;

h) do të emërojë, shkarkojë dhe zëvendësojë Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm si dhe të përcaktojë kompensimin dhe përfitimet e tij/saj, përcaktim ky që duhet të pasqyrohet në deklaratën e politikës së kompensimit të kërkuar sipas Nenit 20.4;

i) do të sigurojë që zyra e auditimit të brendshëm të organizohet dhe të pajiset me personel në mënyrë të rregullt dhe adekuate, dhe rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kësaj zyre si dhe do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm dhe zyrën e auditimit të brendshëm;

j) do t'i shqyrtojë të gjitha Transaksionet me Palët e Ndërlidhura, t'i autorizojë ato të cilat janë të arsyeshme dhe kushtet e të cilave janë të drejta për NP-në ose, nëse aplikohen kufizimet e përcaktuara në Nenin 36.1, ta këshillojë Aksionarin(ët) mbi arsyeshmërinë dhe drejtësinë e tyre;

k) do t'i mbajë sekret në mënyrë rigoroze të gjitha raportet jo-anonime të cilat paraqiten nga një punonjës dhe që kanë të bëjnë me pohime për keq bërje nga një drejtor, zyrtar ose punonjës tjetër i NP-së; do të mbrojtë identitetin e cilitdo person i cili mund t'i nënshtrohet ndëshkimit si rezultat i paraqitjes së një raporti të kësaj natyre; dhe – gjatë mbrojtjes së çfarëdo informatave përkatëse sekrete – shkurtimisht ta informojë punonjësin i cili ka paraqitur raportin e lartë përmendur mbi përfundimet e hetimit i cili është iniciuar si rezultat i paraqitjes së raportit nga ana e tij; dhe

l) kur është e nevojshme, do t'i propozojë Bordit të Drejtorëve masa të cilat mund të jenë të nevojshme për zbatimin e detyrave fiduciare të Zyrtarit për Auditim të Brendshëm.

Neni 26 Kompetencat e Komisionit të Auditimit

Komisioni i Auditimit është i autorizuar që:

a) t'a udhëzojë Zyrtarin për Auditim të Brendshëm që të kryejë detyra dhe veprime të cilat janë në kuadër të kompetencave të Komisionit të Auditimit;

b) të marrë çfarëdo informata lidhur me veprimtarinë dhe punët e NP-së nga cilido zyrtar ose punonjës i NP-së;

c) të kërkojë këshilla nga profesionistë të pavarur, të prokuruar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, kurdo që një çështje me arsye kërkon pavarësinë e këtyre këshilltarëve nga zyrtarët ose menaxherët e lartë të NP-së;

d) të kërkojë mbajtjen e një mbledhje të Bordit të Drejtorëve, dhe të tregojë agjendën e kësaj mbledhje;

e) t'ua parashtojë çfarëdo çështje që ka të bëjë me NP-në gjykatave ose organeve kompetente për zbatimin e ligjit;

f) të mbajë sekret nga Bordi i Drejtorëve çfarëdo informata lidhur me aktivitetet e tij për të cilat me arsye nevojitet mbajtja e sekretit deri në përmbylljen e atij aktiviteti.

Neni 27

Mbledhjet

Rregulloret do të përcaktojnë procedurat e Komisionit të Auditimit në një mënyrë që siguron pavarësinë e Komisionit si dhe ushtrimin efikas dhe me kohë të funksioneve dhe kompetencave të cilat i janë dhënë me këtë ligj.

KREU VI

Dispozitat e tjera

Neni 28

Vlerësimi i Efektshmërisë së Bordit të Drejtorëve

28.1 Bordi i Drejtorëve të NP po ashtu në bazë vjetore do të bëjë një vlerësim sistematik të performancës së vet. Kryesuesi është kryesisht përgjegjës për të siguruar kryerjen e rregullt dhe me kohë të vlerësimit. Vlerësimi do të analizojë performancën përgjithshme të bordit si dhe efektshmërinë dhe kontributin e anëtarëve individual të bordit. Vlerësimi po ashtu, ndër tjera, do të vlerësojë llojlojshmërinë e aftësive dhe përvojës si dhe kualifikimet tjera profesionale me qëllim të vlerësimit të efektshmërisë së Bordit në tërësi dhe komisioneve të tij. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, bordi mund të kërkojë këshilla nga ekspertë të jashtëm dhe të pavarur si dhe nga përfaqësuesit e Aksionarit(ëve).

28.2 Bordi duhet të sigurojë që rezultatet e vlerësimit të realizuar sipas paragrafit 1 të këtij neni të përmbliken në një raport me shkrim i cili i dërgohet (i) Ministrit dhe Qeverisë së Kosovës për NP Qendrore, dhe (ii) anëtarëve të Komisionit(ëve) Komunal të Aksionarëve për NP Lokale.

28.3 Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP, në bazë vjetore, do të vlerësojë efektshmërinë e drejtorëve të secilës NP. Të gjithë zyrtarët dhe drejtorët e NP-së përkatëse duhet të bashkëpunojnë plotësisht me Njësinë për Politikën dhe Monitorimin e NP gjatë kryerjes së këtij vlerësimi. Në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik, Njësia për Monitorimin e NP mund të angazhojë një ose më shumë këshilltarë profesional ose kompani të këshillimit për të ndihmuar në kryerjen e këtij vlerësimi. Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve do ta publikojë këtë vlerësim vjetor në faqen e saj në internet.

Neni 29

Raportet mbi Përbushjen e Nevojave të Klientëve

Nën përgjegjësinë e KE-së, NP rregullisht do të testojë kënaqësinë e konsumatorëve me shërbimet të cilat i ofron. Ndërmarrja do të miratojë procedurat përkatëse dhe do të nxjerrë një raport të thjeshtë i cili paraqet nivelin e kënaqësisë së konsumatorëve si dhe vërejtjet e KE-së lidhur me çdo ndryshim të këtij niveli. Ky raport i dorëzohet (i) Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve, e cila e publikon atë në faqen e saj në internet dhe (ii) sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit(ëve) përkatës Komunal të Aksionarëve.

Neni 30

Plani i Biznesit

30.1 Deri me 31 tetor të çdo viti kalendarik, zyrtarët e secilës NP duhet të përgatisin Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm kalendarik. Ky plan duhet që së pari ti dorëzohet për miratim Bordit të Drejtorëve. Pas miratimit, Plani Afarist i dorëzohet, për qëllime të informimit vetëm, sipas rastit, Ministrit dhe Qeverisë ose Komisionit(ëve) përkatëse Komunale të Aksionarëve. Plani Afarist duhet të analizojë së paku, si vijon:

- a) një përshkrim të synimeve afariste dhe financiare të cilat synohen të arrihen nga NP si dhe orarin për realizimin e tyre;
- b) mënyrat e zgjedhura për arritjen e këtyre synimeve;
- c) përcaktimin e shpenzimeve të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrës për financimin e shpenzimeve;
- d) veprimet të cilat duhet të ndërmerren për arritjen e synimeve; dhe

e) detyrimet e NP karshi konsumatorëve dhe publikut.

30.2 Të gjitha Planet e Biznesit janë dokumente publike. Megjithatë, nëse NP ushtron veprimtarinë një një treg i cili aktualisht karakterizohet me konkurrencë të lartë ose që me arsye pritet se do të karakterizohet me konkurrencë të lartë gjatë 24 muajve të ardhshëm, të gjitha të dhënat në Planin e Biznesit të cilat, nëse do të bëheshin publike, me arsye pritet se do të ndikojnë negativisht në pozitën konkurruese të NP-së në treg, do të mbahen të fshehta dhe nuk do të bëhen publike. Në raste të këtilla, NP duhet të përgatisë versionin publik të Planit të Biznesit i cili nuk i përmban të dhënat e lartpërmendura.

Neni 31 Raportet Vjetore dhe Tremujore

31.1 Brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin dhe dorëzojnë në Bordin e Drejtorëve një raport për tremujorin e sapo përfunduar ("tremujori përkatës") i cili përmban si vijon:

- a) një pasqyrë të strukturës organizative të NP, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë tremujorit përkatës;
- b) një shqyrtim të performancës afariste dhe financiare gjatë tremujorit përkatës;
- c) një përmbledhje të të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë NP-në;
- d) një përshkrim të procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të cila NP pritet t'i iniciojë gjatë tremujorit aktual;
- e) transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse; dhe
- f) sugjerime dhe propozime për ndryshime të cila me arsye pritet që ta rrisin performancën e NP-së.

31.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit tremujor, Bordi i Drejtorëve të NP do ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e sheh të arsyeshme ta miratojë dhe dorëzojë, secilin raport të këtillë tremujor, sipas rastit, Ministrin dhe Qeverisë ose Komisionit(eve) Komunal të Aksionarëve.

31.3 Brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Zyrtarët e NP-së, në përputhje me Nenin 14.1, do të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmeria e përgjithshme në realizimin e caqeve të vendosura në Planin e Biznesit. Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve të NP do ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e sheh të arsyeshme ta miratojë dhe dorëzojë, secilin raport të këtillë vjetor (i) Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve, e cila e publikon atë në faqen e saj zyrtare në internet dhe (ii), sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit(eve) Komunal të Aksionarëve. Bordi i NP-së po ashtu do të publikojë raportet vjetore në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP.

31.4 Bordi i Drejtorëve të NP do t'u përgjigjet menjëherë dhe plotësisht të gjitha kërkesave për informata mbi NP që parashtrahet nga personi ose organi i cili ushtron të drejtat e Aksionarit në NP-në përkatëse (Ministri ose Komisioni Komunal i Aksionarëve, sipas rastit).

31.5 Kushtet për raportim të themeluara në këtë nen i plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara në ligjin e Kosovës.

Neni 32 Deklarata e Konsoliduar Vjetore Financiare për të gjitha NP-të

Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP do të përgatisë dhe publikojë në faqen e saj në internet një deklaratë të konsoliduar vjetore financiare për të gjitha NP-të.

Neni 33 **Auditimi i Jashtëm i NP**

33.1 Çdo NP do t'i nënshtrohet një auditimi të jashtëm vjetor dhe objektiv nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar.

33.2 Auditori duhet t'i sigurojë Bordit dhe Aksionarëve një vlerësim të certifikuar profesional mbi faktin nëse deklaratat financiare të NP-së e paraqesin në mënyrë të drejtë, në përputhje me rregullat dhe parimet e kontabilitetit të përmendura në Nenin 14.1, gjendjen financiare dhe performancën e NP-së në të gjitha aspektet materiale. Auditori po ashtu duhet të sigurojë një opinionin lidhur me mënyrën në të cilën janë përgatitur dhe prezantuar deklaratat financiare të NP-së. Auditori ka detyrime fiduciare ndaj NP-së dhe Aksionarit(ëve) të NP-së për të ushtruar kujdes të shtuar profesional gjatë kryerjes së autorizimit të jashtëm dhe përgatitjes së vlerësimit dhe opinionit të kërkuar sipas këtij Neni 33.2.

33.3 Zyrtari i Prokurimit i NP-së do të prokurorë shërbimet e një auditori për kryerjen e auditimit të jashtëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik dhe me nenin 33. Kontrata përkatëse do të ketë kohëzgjatje prej tri (3) viteve.

33.4 Komisioni i Auditimit të NP-së do ta ndihmojë Zyrtarin e Prokurimit të NP-së gjatë përgatitjes së kritereve të përshtatshmërisë profesionale të cilat do të përdoren gjatë ushtrimit të këtij prokurimi. Këto kritere duhet të sigurojnë pavarësinë dhe kompetencën e auditorit të prokuruar për ofrimin e shërbimeve të auditimit të jashtëm. Komisioni i Auditimit po ashtu do t'i përgatisë dispozitat e kontratës përkatëse që kanë të bëjnë me fushëveprimin dhe planin e auditimit të jashtëm.

33.5 Asnjë person nuk ka të drejtë të dorëzojë tender për një kontratë për ofrimin e shërbimeve të auditimit për një NP nëse dhënia e kontratës në fjalë do të shkaktoje ose kërkonte nga personi në fjalë që të ofrojë shërbime të auditimit për NP-në përkatëse për më shumë se tri vite në një periudhë gjashtë vjeçare. Auditori të cilit i është dhënë një kontratë nga një NP për kryerjen e një auditimi të jashtëm në atë NP nuk ka të drejtë pas përfundimit të asaj kontrate të punësohet ose angazhohet nga NP për një periudhë dy (2) vjeçare.

33.6 Një auditor i cili ka ofruar shërbime që nuk kanë të bëjnë me auditimit për cilëndo NP brenda dymbëdhjetë (12) muajve para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve, nuk ka të drejtë të dorëzojë tender në një prokurim të ushtruar nga një NP për shërbime të auditimit të jashtëm.

33.7 Nëse një auditor ka një kontratë ekzistuese me një NP ofrimin e shërbimeve të auditimit të jashtëm, ky auditor, gjatë kohëzgjatjes së kontratës nuk do të ofrojë shërbime që nuk kanë të bëjnë me auditimin për atë NP ose cilëndo NP tjetër; çdo kontratë e cila epet nga një NP për shërbime të auditimit të jashtëm duhet të përmbajë një dispozitë e cila e vendos këtë kufizim.

33.8 Të gjithë drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe kontraktorët e NP duhet të bashkëpunojnë plotësisht me auditorin gjatë kryerjes së auditimit të jashtëm.

33.9 Çdo drejtor dhe zyrtar i një NP është përgjegjës për të siguruar që NP t'i përmbushë kushtet për auditim të jashtëm të themeluara në këtë nen. Nëse një drejtor ose zyrtar nuk i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme brenda kompetencave të tij/saj për të siguruar përputhjen e NP me këtë kusht, kjo do të konsiderohet arsye e mjaftueshme ligjore për largimin e tij të menjëhershëm nga (i) Aksionarët, në rastin e drejtorit ose (ii) Bordi, në rastin e zyrtarit.

Neni 34 **Rregulloret**

34.1 Të gjitha NP do të përgatisin dhe vejnë në fuqi rregulloret të cilat kërkohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Miratimi, ndryshimi dhe plotësime si dhe shfuqizimi i Rregulloreve të NP është kompetencë ekskluzive e Aksionarit(ëve) të NP-së; megjithatë, Aksionari(ët) e NP-së duhet të sigurojë që rregulloret të jenë në përputhje me këtë ligj dhe modelet e rregulloreve të shpallura nga Ministri sipas paragrafit 4 të këtij neni.

34.2 Një kopje e plotë dhe aktuale e të gjitha rregulloreve të NP-së do të publikohet dhe mbahet në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP-ja.

34.3 Dispozitat e rregulloreve të NP-së duhet të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligjin e Kosovës. Përveç kësaj, rregulloret e NP-së gjithashtu duhet të përmbajnë dispozita të cilat përshkruajnë në mënyrë të hollësishme:

a) titujt, detyrat dhe kompetencat e secilit Zyrtar të NP-së;

b) politikat e NP-së për rekrutimin e menaxhmentit si dhe vlerësimin e efektshmërisë në përputhje me standardet e drejtësisë dhe transparencës;

c) procedurat e NP-së për monitorimin dhe kontrollimin e konfliktit të interesave;

d) politikën e NP-së lidhur me Transaksionet me Palët e Ndërlidhura, dhe procedurat e raportimit dhe miratimit të këtyre transaksioneve;

e) procedurat e NP-së për shpalljen publike të informatave materiale mbi (i) NP-në (duke përfshirë informatat mbi transaksionet e konsiderueshme, gjendjen financiare si dhe vendimet e rëndësishme të Bordit), dhe (ii) aktivitetet ekonomike të “të brendshmeve”; dhe

f) rregullat mbi transaksionet ndërmjet/me njësitë ndihmëse të NP-së; procedurat e NP-së për monitorimin e këtyre transaksioneve dhe për të siguruar zbulimin e tyre para Bordit të Drejtorëve dhe organit ose organeve të cilat ushtrojnë të drejtat e aksionarit në NP (Qeveria ose Komisioni(et) Komunal i Aksionarëve).

34.4 Ministria është e autorizuar dhe ka detyrimin për të shpallur një grup të modeleve të rregulloreve për shfrytëzim nga NP-të, dhe secila NP duhet të sigurojë që rregulloret e saj të jenë në përputhje me këto modele. Ministria duhet të sigurojë që modelet e rregulloreve të jenë në përputhje me këtë ligj dhe ligjet e tjera të aplikueshme të Kosovës si dhe ti pasqyrojnë standardet e pranuar ndërkombëtare të qeverisjes korporative dhe ndërmarrjeve publike. Ministria po ashtu duhet të marrë parasysh modelet e rregulloreve të NP të miratuara paraprakisht nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Neni 35 Kodi i Etikës

35.1 Të gjitha NP duhet të përgatisin, miratojnë dhe zbatojnë një kod të detyrueshëm të etikës dhe qeverisjes korporative.

35.2 Kodi i etikës dhe qeverisjes korporative (i) e zotën NP-në për zbatimin e standardeve më të larta të mirësjelljes dhe praktikave afariste; dhe (ii) duhet të jetë mjaft i hollësishëm në mënyrë që të ofrojë udhëzime të qarta mbi sjelljen që pritet nga drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe konsulentët profesional të NP-së; dhe (iii) të krijojë një program për mbrojtjen e personave të cilët zbulojnë para publikut fakte për keq bërje (aktivitete të paligjshme) brenda ndërmarrjes.

35.3 Çdo drejtor dhe zyrtar i NP-së duhet të nënshkruajë një zotim me shkrim për respektimin e kodit të etikës dhe qeverisjes korporative si dhe për marrjen e të gjitha masave të arsyeshme për të siguruar zbatimin e këtij kodi nga NP dhe të gjithë personat e punësuar ose të angazhuar profesionalisht nga NP.

35.4 Ministria është e autorizuar dhe ka detyrimin për të shpallur një model të kodit të etikës dhe qeverisjes korporative për shfrytëzim nga NP-të, dhe secila NP duhet të sigurojë që kodi i saj të jenë në përputhje me këtë model. Ministria duhet të sigurojë që modeli i kodit të etikës të jenë në përputhje me këtë ligj dhe ligjet e tjera të aplikueshme të Kosovës si dhe ti pasqyrojnë standardet e pranuar ndërkombëtare për kodet e etikës dhe qeverisjes korporative. Ministria po ashtu duhet të marrë parasysh modelin e kodit për qeverisje korporative për NP të miratuar paraprakisht nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Neni 36 Konflikti i Interesave

36.1 Drejtorët dhe zyrtarët e një NP nuk mund të hyjnë në marrëveshje me atë NP, përveç nëse ajo marrëveshje së pari miratohet nga Aksionarët. Ky kufizim nuk aplikohet për kontratat e punësimit të Zyrtarëve, për të cilat kërkohet vetëm miratimi i Bordit të Drejtorëve.

36.2 Drejtorët dhe zyrtarët e një NP do t'i zbulojnë plotësisht me shkrim para Bordit të Drejtorëve të NP-së çfarëdo interesa personale të çfarëdo natyre të cilat mund t'i kenë në lidhje me një aksion ose një vendim afarist i cili do të merret nga NP; në veçanti, ata duhet që gjithmonë t'i zbulojnë të gjitha Interesat Financiar të cilat mund t'i kenë në (i) konkurruesit afarist; (ii) kreditorët; (iii) furnizuesit e mallrave ose shërbimeve; ose (iv) konsumatorët afarist, të NP-së.

36.3 Zbulimi i konfliktit të interesave i përmendur në nenin më sipër duhet të bëhet nga çdo individ në kohën kur çështja përkatëse shfaqet ose në kohën kur individi merr pozitën përkatëse në NP.

36.4 Një zyrtar ose drejtor është absolutisht i ndaluar që të marrë pjesë ose të përpikët të ndikojë – në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë – në çfarëdo mbledhje, diskutimi, negociimi, vendimi ose propozim-veprimi të Bordit të Drejtorëve ose zyrtarëve të NP-së, kur mbledhja, diskutimi, negociimi, vendimi ose propozim-vendimi i sipër cekur ka të bëjë me një çështje në të cilën zyrtari ose drejtori në fjalë ka një interes personal (duke përfshirë një interes financiar) i cili mundet, qoftë edhe potencialisht, të bie ndesh me interesat e NP-së.

36.5 Çdo vendim i cili miratohet nga Bordi i Drejtorëve ose nga Komisioni i Auditimit dhe i cili është votuar ose ndikuar nga një zyrtar ose drejtor i cili vepron në kundërshtim me Nenin 36.4 është i pavlefshëm dhe i pa zbatueshëm, dhe çdo aksionar ose drejtor mundet formalisht dhe me shkrim të paraqesë kërkesë para Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit, sipas rastit, për zhvleftësimin formal të këtij vendimi. Nëse Bordi i drejtorëve ose Komisioni i Auditimit, brenda tridhjetë (30) ditëve pas dorëzimit të kërkesës, dështon ose refuzon të merr masa për zhvleftësimin e vendimit të lartë përmendur, atëherë cilido aksionar ose drejtor në fjalë mund të dorëzojë kërkesë në gjykatën kompetente për nxjerrjen e një vendimi gjyqësor i cili e deklaron vendimin e lartë përmendur të pavlefshëm dhe të pa zbatueshëm.

36.6 Zyrtarët duhet të abstenojnë nga marrja e çfarëdo veprimi lidhur me një çështje në të cilën kanë një interes personal (duke përfshirë Interesat Financiare) i cili, qoftë edhe potencialisht, mund të bie ndesh me interesat e NP-së, përveç nëse ky veprim merret për zbatimin e një vendimi aktualisht të vlefshëm të miratuar paraprakisht nga Bordi i Drejtorëve ose Komisioni i Auditimit.

Neni 37

Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP-ve në Ministri

37.1 Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP-ve ("Njësia për NP") do të themelohet nga Ministri në kuadër të Ministrisë me qëllim të mbështetjes së Ministrit dhe Qeverisë në ushtrimin e përgjegjësive për NP-të të cilat u janë dhënë atyre me këtë ligj. Udhëheqësi i Njesisë për NP do të emërohet nga Ministri.

37.2 Njësia për NP gjithashtu do të:

- a) përgatisë dhe dorëzojë Ministrit, për transmetim në Qeveri, analiza dhe rekomandime lidhur me çështjet e NP Qendrore që janë në kompetencën e Ministrit dhe/ose Qeverisë;
- b) përgatisë dhe dorëzojë Ministrit propozim procedura për mbikëqyrjen e NP-ve Qendrore dhe monitorimin e përputhjes së tyre me këtë ligj dhe ligjet e tjera të rëndësishme; dhe
- c) mbledhë të dhënat përkatëse mbi NP-të dhe ofron përkrahje, sipas nevojës, për Departamentin e Buxhetit lidhur me të gjitha aspektet e BKK-së që ndërlidhen me NP-të.

37.3 Njësia për NP do të krijojë një faqe në internet në të cilën duhet të publikojë deklaratën e konsoliduar financiare vjetore për të gjitha NP-të e cila kërkohet nga Neni 32.

37.4 Për secilën NP, Njësia për NP po ashtu do të publikojë:

- a) të gjitha informatat, raportet, deklaratat financiare si dhe vlerësimet e kërkuara sipas këtij ligji për NP-në ose Bordin e saj;
- b) statutin dhe rregulloret e NP-së;

c) versionin publik të Planit të Biznesit të NP-së;

d) të gjitha vendimet ose veprimet e marra nga Qeveria, Ministri ose një Komision Komunal i Aksionarëve sipas këtij ligji ose Ligjit për Shoqëritë Tregtare lidhur me NP-në ose Bordin e saj, duke përfshirë – por pa u kufizuar: (a) të gjitha veprimet ose vendimet e marra për ushtrimin e të drejtave të aksionarit, dhe (b) të gjitha veprimet ose vendimet e marra për zbatimin e detyrimeve fiduciare të Bordit të Drejtorëve si dhe rezultatin e vendimeve ose veprimeve në fjalë, duke përfshirë një përkthim të shkëlqes së pretenduar, mjetet e kërkuara juridike si dhe çfarëdo vendimi gjyqësor mbi rastin; sidoqoftë, asnjë informatë e këtillë nuk do të publikohet nëse dhe përderisa e paragjykon kryerjen e një hetimit në vazhdim e sipër për shkeljen e pretenduar;

e) kompensimin, dhe kushtet e kompensimit, për secilin drejtor dhe zyrtar të NP-së;

f) të gjitha të dhënat materiale mbi secilin Transaksion me një Palë të Ndërlidhur, si dhe një deklaratë – nën përgjegjësinë kolektive të bordit të drejtorëve – mbi atë se nëse transaksioni në fjalë është bërë me kushte të tregut;

g) të gjitha kontratat e prokurimit me vlerë të madhe, siç janë përkufizuar në Ligjin për Prokurim Publik;

h) të gjitha kontratat e prokurimit – pavarësisht nga vlera e tyre – të cilat janë lidhur pa shfrytëzimin e një procedure konkurruese të tenderimit; dhe një deklaratë – nën përgjegjësinë kolektive të bordit të drejtorëve – mbi atë se nëse secili nga këto transaksione janë bërë me kushte të tregut;

i) detyrimet për shërbime publike të cilat i janë dhënë NP-së me ligj;

j) të gjitha konfliktet e interesave të deklaruara nga drejtorët dhe zyrtarët;

k) listën e dhjetë furnizuesve më të mëdhenj të saj për nga vlera e furnizimeve;

l) numrin e punonjësve të saj, të ndarë në bazë të divizioneve, dhe një pasqyrë të ndryshimeve mujore.

37.5 Njësia për NP po ashtu do të publikojë të gjitha aktet nënligjore, modelet e kodeve dhe rregulloreve të nxjerra në bazë të autorizimit të këtij ligji.

37.6 Njësia për NP duhet t'i mbajë në faqen e saj në internet të gjitha të dhënat e kërkuara sipas paragrafëve 3-5 të këtij neni për një periudhë pesë (5) vjeçare.

37.7 Qeveria, Ministria, çdo NP dhe çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet që menjëherë të sigurojnë Njesisë për NP të gjitha të dhënat e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni në kohën kur këto të dhëna janë në posedim ose kontroll të tyre.

37.8 Të gjitha të dhënat e përshkruara në paragrafët 3-5 të këtij neni duhet të vendosen për qasje publike dhe duhet të zbulohen në përputhje me Ligjin për Qasjen në Dokumentet Zyrtare. Ky paragraf nuk do të interpretohet ose të zbatohet me qëllim të kufizimit të fushëveprimit të atij Ligji.

KREU VI

Dispozitat Përfundimtare dhe Kalimtare

Neni 38

Mbizotërimi i Këtij Ligji ndaj Ligjeve të Mëparshme

38.1 Ky ligj do t'i zëvendësojë dhe do të mbizotërojë ndaj të gjitha dispozitat në aktet legislative ose normative të cilat nuk janë në përputhje me të; megjithatë, nëse shfaqet konflikti ndërmjet këtij ligji dhe neneve 21-30 të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës, këto nene të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës do të mbizotërojnë.

38.2 Nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ligji për Auditimin e Brendshëm nuk do të aplikohet për NP-të.

Neni 39

Disponimi me Aksionet dhe Detyrimet e Mbajtura ose Paraprakisht të Marra Përsipër nga Shoqëritë Holding

39.1 Të gjitha shoqëritë tregtare paraprakisht të krijuara (themeluara) nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit që mbajnë aksione në një ose më shumë ndërmarrje publike ("Shoqëri Holding") menjëherë duhet ti bartin këto aksione në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Të gjitha aksionet në një NP Lokale të cilat pranohet nga Ministria menjëherë do të barten nga Ministria në NP-në Lokale, e cila më pas ua shpërndan aksionet komunës ose komunave përkatëse sipas Listës 2. Pas pranimit të të gjitha aksioneve të NP-së nga një Shoqëri Holding, Ministri do të ketë kompetenca të plota ligjore dhe përgjegjësinë për të marrë çfarëdo masa të nevojshme për shpërbërjen e Shoqërisë Holding.

39.2 Nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha borxhet dhe detyrimet e papaguara financiare të Shoqërisë Holding do t'i barten dhe do të merren përsipër nga NP e cila njëkohësisht me inkorporimin e saj si shoqëri aksionare sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/6, ka marrë pronësinë ose posedimin e të gjitha ose një pjese të konsiderueshme të aseteve operative dhe të tjera të ndërmarrjes e cila fillimisht ka hyrë në këtë borxhe ose detyrime; me kusht që nëse këto asete i janë bartur më shumë se një shoqërie aksionare, atëherë secili shoqëri e këtyllë do të jetë bashkërisht dhe individualisht përgjegjëse për borxhet dhe detyrimet e pa përmbushura të ndërmarrjes e cila fillimisht i kishte krijuar këto borxhe ose detyrime, dhe secila shoqëri e këtyllë ka të drejtë të pranojë kontribute nga të tjerat nëse asaj i kërkohet që të paguajë ose për ndryshe të përmbushë me shumë se pjesën e saj të këtyre borxheve ose detyrimeve (pjesa e saj është e barabartë me përqindjen, e përcaktuar në bazë të vlerës, të aseteve të ndërmarrjes fillestare të cilat i janë bartur kësaj shoqërie).

39.3 Republika e Kosovës do të ketë përgjegjësi të pakufizuar, si garantues, për pagimin e këtyre borxheve ose detyrimeve të tjera financiare nëse, sipas ligjit të aplikueshëm në kohën e krijimit të borxhit ose detyrimit: (i) themeluesit, pronarët, partnerët, poseduesit e interesave pronësore ose aksionarët, sipas rastit, të personit juridik ose subjektit tjetër i cili ka krijuar këtë borxh ose detyrim – dhe i cili më vonë është transformuar në Shoqërinë përkatëse Holding – ishin në mënyrë të pakufizuar përgjegjës për detyrimet e këtij personi juridik ose subjekti; ose (ii) biznesi ose subjekti i cili ka krijuar borxhin ose detyrimin - dhe i cili më vonë është transformuar në Shoqërinë përkatëse Holding – nuk ka gëzuar personalitet të ndarë juridik nga themeluesit, pronarët, partnerët ose poseduesit e interesave pronësore, sipas rastit. Të gjitha këto detyrime, borxhe dhe përgjegjësi të tjera do të vazhdojnë t'i nënshtrohet ligjeve të tyre përkatëse të aplikueshme, dhe asgjë në këtë ligj nuk do të ndikojë negativisht në cilëndo të drejtë ose prerogativë të kreditorëve përkatës të cilët kanë ekzistuar menjëherë para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

39.4 Nëse një person ose entitet parashton një pretendim ose padi me të cilën kërkon nga NP-ja ose Qeveria pagimin e një borxhi ose detyrimi financiar, NP-ja ose Qeveria, sipas rastit, kanë të drejtë të shfrytëzojnë çdo mbrojtje juridike të cilat i kanë në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm në lidhje me vlefshmërinë ose afatshmërinë e paraqitjes së pretendimit ose padisë.

39.5 Pa paragjykuar sa u tha më sipër, asgjë në këtë nen nuk do të interpretohet për të ndikuar në afatet e aplikueshme ligjore kohore mbi të drejtën e pretenduesit për paraqitjen e një padie në gjykatën kompetentë për pagimin e një borxhi ose detyrimi të lartpërmendur.

Neni 40

Ndërmarrjet në të cilat pronësia publike është në pakicë

40.1 Nëse një ndërmarrje është ose bëhet më pak se pesëdhjetë përqind (50%) në pronësi, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të Republikës së Kosovës në tërësi dhe/ose të një ose më shumë autoriteteve publike të Republikës së Kosovës; kjo ndërmarrje nuk është "NP" brenda kuptimit të këtij ligji dhe çdo përmendje e një ndërmarrje të këtyllë në listat që i janë bashkangjitur këtij ligji do të konsiderohet si e fshirë nga këto lista dhe kjo përmendje nuk do të ketë fuqi ose zbatim të mëtutjeshëm.

40.2 Nëse Republika e Kosovës dhe/ose një ose më shumë autoritete publike të Republikës së Kosovës kanë në pronësi, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, aksione ose interesa tjera pronësore në një ndërmarrje e cila nuk është NP brenda kuptimit të këtij ligji, të drejtat përkatëse të aksionarit/pronësisë do të vendosen në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ligjet e tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës.

40.3 Të drejtat e këtyre aksioneve ose interesave pronësore në pronësi publike në këtë ndërmarrje do të ushtrohen nga autoriteti ose autoritetet përkatëse publike të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji. Ushtrimi i këtyre të drejtave duhet të bëhet në përputhje me, mutatis mutandis, dispozitat e këtij ligji të cilat e rregullojnë ushtrimin e të drejtave të aksionarëve. Nëse autoriteti përkatës publik ka të drejtë të propozojë kandidatë për bordin e ndërmarrjes, propozimi i kandidatëve nga ky organ do të bëhet, mutatis mutandis, në përputhje me dispozitat e aplikueshme të nenit 15 ose nenit 16 të këtij ligji..

40.4 Shitja ose propozimi për shitjen e këtyre aksioneve ose interesave pronësore në pronësi publike rregullohet sipas nenit 9 të këtij ligji; sidoqoftë, nëse ekziston një marrëveshje me aksionarët ose pronarët e tjerë e cila paraprakisht është lidhur për një shitje ose privatizim i cili është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, dhe kjo marrëveshje përmban dispozita për rregullimin e shitjes së këtyre aksioneve, atëherë ato dispozita mbizotërojnë në rast të konfliktit me nenin 9 të këtij ligji..

Neni 41

Ndalesa për Lënien Peng ose Vendosjen e Barrës mbi Aksioneve dhe Interesave në Pronësi Publike

Aksionet ose interesat tjera pronësore të cilat janë në posedim ose pronësi të cilitdo autoritet publik në një shoqëri tregtare ose ndërmarrje tjetër nuk mund të lihen peng, të hipotekohen, të vendoset barrë ose të përdoren si siguri për pagimin ose përmbushjen e çfarëdo detyrimi financiar ose detyrimi tjetër.

Neni 42

Aktet Nënligjore

Qeveria është e autorizuar që të shpallë të gjitha aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin dhe respektimin e këtij ligji.

Neni 43

Bordet e Përkohshme të Drejtorëve

43.1 Qeveria është e autorizuar që të emërojë një Bord të Përkohshëm të Drejtorëve ("Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve") për secilën NP për të shërbyer në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së për një periudhë gjashtë mujore duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

43.2 Qeveria do ta ushtrojë këtë autoritet sa më shpejtë që të jetë e mundshme pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

43.3 Secili Bord i Përkohshëm i Drejtorëve do të përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe duhet të përfshijë KE-në ose menaxherin e lartë të NP-së. Gjatë emërimit të drejtorëve të tjerë të një Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve, Qeveria do të bëjë përpjekje maksimale për të siguruar që këta drejtorë t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 4 të nenit 17 të këtij ligji.

43.4 Mandati i secilit Bord të Përkohshëm të Drejtorëve do të skadojë, cilado që ndodh më herët (i) mesnatën e ditës e cila rastis gjashtë (6) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji ose (ii) ditën në të cilën zgjidhet bordi i plotë i drejtorëve për NP-në përkatëse në përputhje me nenin 15 ose 16 të këtij ligji..

43.5 Çdo përpjekje për zgjatjen ose përtëritjen e mandatit të një Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve përtej afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni është e ndaluar, e pavlefshme dhe e pa zbatueshme. Pas skadimit të mandatit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, ky bord dhe drejtorët e tij pushojnë të kenë çfarëdo autorizimi të çfarëdo përshtkrimi për të vepruar në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së.

Neni 44

Hyrja në Fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-087
13 qershor 2008

Lista 1
Ndërmarrjet Publike Qendrore

1. Korporata Elektroenergjetike e Kosovës Sh.A (KEK);
2. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, Sh.A (KOSTT);
3. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A (PTK)
4. Hekurudhat e Kosovës Sh.A;
5. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Sh.A;
6. Kompania për Menaxhimin e Deponive Sh.A;
7. NPH Iber Lepenc Sh.A;
8. Radio Televizioni i Kosovës (RTK).

Kompanitë Rajonale të Ujitjes

1. Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë Sh.A.
2. Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A

Kompanitë Rajonale të Ujësllësit

1. Kompania Rajonale e Ujësllësit Prishtina Sh.A, Prishtinë
2. Kompania Rajonale e Ujësllësit Hidrodrini Sh.A, Pejë
3. Kompania Rajonale e Ujësllësit Hidroregjioni Jugor Sh.A, Prizren
4. Kompania Rajonale e Ujësllësit Mitrovica Sh.A, Mitrovicë
5. Kompania Rajonale e Ujësllësit Hidromorava Sh.A, Gjiilan
6. Kompania Rajonale e Ujësllësit Radoniqi Sh.A, Gjakovë

Lista 2
Ndërmarrjet Publike Lokale

- | | |
|--|-----------------------------|
| 1. Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A, Prishtinë | Prishtina 100% |
| 2. Ngrohtorja e Qytetit Gjakova Sh.A, Gjakovë | Gjakova 100% |
| 3. Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabрати Sh.A, Gjakovë | Gjakova 100% |
| 4. Kompania e Mbeturinave JKP Standard, Mitrovicë | Mitrovica 100% |
| 5. Kompania e Mbeturinave JKSP Zveçan, Zveçan | Zveçan 100% |
| 6. Kompania e Ujësllësit dhe Mbeturinave Ibri, Zubin Potok | Zubin Potoku 100% |
| 7. Kompania e Ujësllësit dhe Mbeturinave 24 Nëntori, Leposaviq | Leposaviq 100% |
| 8. Kompania Rajonale e Ujësllësit Bifurkacioni Sh.A, Ferizaj | Ferizaj 85.3% Kaçanik 14.7% |
| 9. Ndërmarrja Publike Banesore, Prishtinë | Prishtina 100% |
| 10. NP Tregu, Mitrovicë | Mitrovica 100% |
| 11. Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A, Prishtinë | |
| 12. Kompania Rajonale e Mbeturinave Ambienti Sh.A, Pejë | |
| 13. Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastërtia Sh.A, Ferizaj | |

14. Kompania Rajonale e Mbeturive Eco-Regjioni Sh.A, Prizren
15. Kompania Rajonale e Mbeturive Higjiene Sh.A, Gjilan
16. Kompania Rajonale e Mbeturive Uniteti Sh.A, Mitrovicë